



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 306, datë 29.12.2020

MBI VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS TË MAGJISTRATIT ZNJ. ELENA PELUSHI (BAKALLBASHI), KANDIDAT PËR T'U KOMANDUAR INSPEKTOR PRANË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË.

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 159, 184 dhe 189, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, neneve 32, 35 dhe 55, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimin nr. 171, datë 27.9.2019, Rregullores “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, e ndryshuar, si dhe pasi u njoh me Relacionin “ Mbi verifikimin e pasurisë, figurës të magjistratit, kandidat për t’u komanduar Inspektor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, znj. Elena Pelushi (Bakallbashi)”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Të vlerësojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës të kandidatit për t’u komanduar Inspektor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, znj. Elena Pelushi (Bakallbashi), sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Lejimin e kandidatit prokuror, znj. Elena Pelushi (Bakallbashi) dhe vijimin e procedurës të komandimit si Inspektor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
3. Të njoftohet për këtë vendim znj. Elena Pelushi (Bakallbashi).
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
GENT IBRAHIMI


ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA



ANËTAR
KOSTAQ BELURI



ANËTAR
BUJAR SHESHI



ANËTAR
NURIHAN SEITI



ANËTAR
SANDËR BECI



ANËTAR
VATË STAKAJ

ANËTAR
TARTAR BAZAJ



ANËTAR
ESMERALDA KESHI

